

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtaren FranciskaZhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. p. Q. e D. t. N. “K.P.” me seli në P., me nr. të biznesit ...,të cilën e përfaqëson avokati V.V. nga P.,kundër të paditurit Republika e Kosovës,Qeveria Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N.A. sipas autorizimit me shkrim, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 556,707.38 euro,në seancën e mbajtur më datë 03.09.2018 në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, ndërsa dhe me datën;10.09.2018 merr këtë,

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadi e paditësit N. p. Q. e D. t. N. “K.P.” me seli në P..

I.DETYROHET e paditura Republika e Kosovës,Qeveria Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë,që paditësit N. p. Q. e D. t. N. “K.P.” me seli në P. t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 556,707.38 euro (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatë euro e tridhjetë e tetë cent),në emër të fitimit pa bazë e cila rrjedh nga borxhi, me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 20.03.2008 e deri në pagesën definitive të borxhit,të gjitha këto në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II.Detyrohet e paditura Republika e Kosovës,Qeveria Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë që paditësit t’ia paguaj shumën prej 2.355 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m i

Paditësi N. p. Q. e D. t. N. “K.P.” me seli në P. ka paraqitur padi me datën 20.03.2008, pranë Gjykatës Komonale në Prishtinë tani Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti Civil,kundër paditurit Republika e Kosovës,Qeveria Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë , duke kërkuar që t’ia paguaj borxhit në shumë prej 556,707.38 Euro.

Gjykata Komonale në Prishtinë tani Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti Civil me Aktgjykimin C.nr.500/2008 të datës 26.11.2012 kishte refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ,kundër këtij Aktgjykimit e paditura kishin ushtruar ankesë në bazë të të cilës Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ae.nr.1533/13, dt.20.10.2016 ankesën e paditësit e ka aprovuar ndërsa lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Më pas Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil me aktvendim C.nr.2522/16 dt.06.07.2017 është shpallur jo kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar në këtë çështje kontestimore dhe se lëndën e ka dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike.

Kjo gjykatë ka mbajtur seancat lidhur me këtë çështje juridike-civiledhe pas marrjes së mendimin dhe konstatimit të ekspertizës financiare R.B., përfaqësuesi i paditësitka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar që të obligohet i padituri Republika e Kosovës, Qeveria Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë (ish TMK-ja) që paditësit në emër të borxhit të krijuara gjatë periudhës së vitit 1999-2002 për furnizimin me derivate të naftës të ia paguaj shumën e përgjithshme prej 556,707.38 euro, së bashku me kamatën ligjore sipas normës 3.5% në vit nga 12.03.2002 e deri me datën 31.12.2012 në shumë prej 203.780.42 euro, ndërsa nga data 01.01.2013 deri me datën 30.04.2012 shumë prej 237.540.35euro, në shumë të përgjithshëm të borxhit kryesor dhe kamatës prej 998.028.15euro, duke shtuar se borxhi është konfirmuar nga shefi i departamentit të logjistikës Z.KadriKastrati dhe se ky borxh nuk është paguar për shkak të mjeteve financiare, po ashtu me aktin e TMK-së “Akt përcjellës të mjeteve financiare nr.1487 të datës 18.03.2002 i nënshkruar nga shefi i Departamentit të logjistikës Z. I.D. i cili e konfirmon se borxhi është evident por nuk është paguar për shkak të mungesës së mjeteve financiare, prandaj i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurës si në seancat e mbajtura ashtu edhe në parashtrësën me shkrim e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësi duke u thirrur se kjo çështje është e gjykuar si dhe e parashkruar e përmë tepër ka kontestuar edhe legjitimitetin real pasiv në këtë çështje kontestimore sepse në pajtim me nenin 126 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Ligjin nr.03/L-45 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-46 për Forcën e sigurisë së Kosovës, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forca e sigurisë së Kosovës nuk bartin asnjë të drejtë dhe detyrim ndaj ish Trupave Mbrojtës të Kosovës. Kështu Trupat Mbrojtës të Kosovës kanë qenë mekanizëm i paraparë me kornizën kushtetuese të Kosovës dhe janë themeluar me rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/8 të datës 20.09.10999, mbi themelimin e Trupave Mbrojtës të Kosovës, funksionimi i të cilave është përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje sipas së cilit nen “Trupat Mbrojtës të Kosovës veprojnë nën autoritetin e përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm e për më tepër ka shtuar se me faktin se kemi të bëjmë me legjitimitetin real pasiv pasi që nuk ka kontratë të lidhur në mes të palëve në procedurë i cili është mjet juridik i cili krijon të drejtat dhe obligimet në mes të palëve kontraktuese e në këtë rast nuk kemi kontratë të shkruar andaj edhe nuk ekziston asnjë obligim i paditurës ndaj paditësit, dhe mbi këto baza ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të palëve në procedurë ka administruar provat e propozuara nga palët në procedurë dhe atë: vërtetimi me nr. të protekolit 92/07 pa datë, aktvendimi i Gjykatës Ekonomike e Qarkut në Prishtinë II.C.nr.113/2002 e dt.27.06.2002, aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr.115/2002 e dt.10.10.20102, aktpërcjellës i mjeteve financiare e dt.18.03.2002 i nënshkruar nga laz Dërguti shef i departamentit të logjistikës, kundërshtimi kundër aktvendimit me nr.53/2002 e dt.16.05.2002 nga Trupat

Mbrojtës të Kosovës Shtabi i Përgjithshëm me nr.01/352 e dt.31.05.2002, propozimi për ekzekutim e dt.16.05.2002, vëretja para padisë gjyqësore për mos kryerjen e borxhit ushtruar nga paditësi kundër të paditurit me dt.12.03.2002, aktvendimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr.500/08 e dt.26.11.2012, kartela financiare të palës paditëse për periudhën 01.01.2000-30.05.2001, ekspertiza financiare e punuar nga R.B. e dt.15.05.2018.

Deklarimet e të autorizuarit të paditëses, deklaramet e paditurës, ekspertiza poashtu edhe sipas sygjerimevetë Gjykatës së Apelit si dhe provat e prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha, një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të dispozitës së nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së dhe gjeti se;

Kontestuese në këtë çështje juridike ishte baza juridike po ashtu kontestuese ishte edhe fakti se Republika e Kosovës, Qeveria Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë a ka ligjitimitet pasiv në këtë çështje civile-juridike, si dhe parashkrimi lidhur me këtë çështje civile juridike.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 4 dhe 5 të Ligjit për shpërbërjen e trupave mbrojtës të Kosovës –Çështja e trashëgimisë së TMK-së gjegjësisht në nenin 4.1 parasheh se duke iu nënshtruar programit kohor të shpërbërjes së përcaktuar nga neni 3 i këtij ligji mandati i TMK-së si organizatë për emergjencë civile vazhdon të përfshij aktivitetet e përcaktuara në nenin 1 të rregullores së UNMIK-ut nr.1999/8 përfshi:

- a) sigurimin e shërbimeve në raste të fatkeqësive natyrore ,
- b) kërkimin dhe shpëtimin e të rrezikuarve,
- c) ofrimin e mundësive të veta për ndihma humanitare në zonat e izoluara,
- d) ndihmën për çmimin e zonave të minuara dhe
- e) kontributin në rindërtimin e infrastrukturës dhe të komuniteteve, po ashtu sipas nenit 4.2 me qëllim të sigurimit të ofrimit pa ndërprerje i këtyre shërbimeve, përgjegjësia për to i transferohet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në pajtim me programin e shpërbërjes së përcaktuar në nenin 3 të këtij Ligji.

Këto detyra fillimisht parësore të FSK-së janëpërgjigjia ndaj krizave, asgjësimi i lëndëve plasëse dhe mbrojtja civile, ruajtja e këtyre aftësive kyçe është thelbësore dhe do të jetë faktor qendror në përcaktimin e sekuencës së shpërbërjes së TMK-së dhe ngritjes së FSK-së.” Në nenin 5.2 të të njëjtit ligj parashihet se “Prania Ndërkombëtare ushtarake planifikon dhe mbikqyrë transferimin e pasurive të TMK-së tek FSK-ja.” andaj edhe sipas nenit 12.1 është paraparë se Qeveria e Kosovës themelon një organ ndër-qeveritar për të koordinuar çështjet e trashëgimisë së TMK-së, në nenin 12.2 i të njëjtit ligji parashihet se “Derisa Qeveria e Kosovës të marrë përgjegjësi të plota mbi çështjet e trashëgimisë prania ndërkombëtare ushtarake dhe zyra e koordinatorit të TMK-së do të vazhdojnë të ndihmojnë në këtë aspekt, andaj sipas dispozitave të lartë cekura rrjedh se pasuria e TMK-së është transferuar tek FSK-ja, do të thotëse janë transferuar edhe përgjegjësitë për shërbimet, kërkesat dhe obligimet nga TMK-ja tek FSK-ja, kështu që Republika e Kosovës, Qeveria Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka legjitimiteti real pasiv.

Nga Vërtetimi i TMK-së Shtabi i Përhgjitshëm-Departamenti i logjistikës nr. protokollit.92/07 pa datë gjykata ka vërtetuar faktin se shefi aktual i Departamentit të logjistikës Z.KadriKastrati ka dëshmuar se TMK nga data 20.09.1999 se është furnizuar me karburant nga kompania “K.P.”,njëkohësisht ka dëshmuar se kompanisë i janë paguar mjetet financiare në vlerë 611,800.00 DM, kurse për pagesë ka mbetur edhe shuma: 1,088,825.00 DM, andaj edhe mos pagesa e mjeteve të mbetura, është pasojë e mungesës së buxhetit të TMK-së.Vërtetimi vlerësuar në pikëpamje formale është i nënshkruar dhe vulosur si dhe posedon llogon përkatëse që nënkupton se është dokument valid si e tillë,i njëjti dokument është edhe i nënshkruar .

Nga Akti i TMK-së-Departamenti të logjistikës nr.1487 dt.18.03.2002 me emërtim”Akt përcjellës i mjeteve financiare” i cili është dedikuar për Drejtoratin e TMK-së në MPKBN ,Menaxhimit të resurseve dhe arkivit gjykata ka vërtetuar faktin se shef i departamentit të logjistikës Z.IlazDerguti me nënshkrimin e tij dhe vulën e TMK-së ka dëshmuar se TMK-ja qënga shtatori 1999 e gjer me nënshkrimin e kontratës është furnizuar me derivate nga kompania “Kosova Petroll” dhe se pasi qëështë marrë vërejtja e fundit para padisë ka kërkuar që kjo çështje të shqyrtohet seriozisht për sigurimin e mjeteve për kompensimin e kompanisë,kështu me shkresën e njëjtë shefi i departamentit të logjistikës e ka vërtetuar shumën e borxhit të mbetur prej 1,088,825.00DM.

Nga vërejtja para padisë gjyqësore për mos kryerjen e borxhit në shumëe përgjithshme prej 1,088,825.00DM gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i është drejtuar me datën 12.03.2002 drejtuar TMK-së.

Gjykata me propozimin palës paditëse ka aprovuar nxjerrjen e ekspertizës financiare dhe se nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar Riza Blakaj dt.15.05.2018 ka vërtetuar se paditësi përgjatë periudhës së vitit 1999-2002 e ka furnizuar pa kontratë tëveçant Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së me derivate tënaftës,e paditura i ka shlyer detyrimet kundër furnizimit në shumë prej 611,800.00DM,ndërsa ka mbetur borxh ndaj palës paditëse edhe shumën prej 1.088,825.00DM që pas konvertimit rezulton borxhi i pa shlyer në shumën e përgjithshme prej 556.707.38euro dhe se ky borxh rrjedh se është pranuar dhe konfirmuar nga personat përgjegjës të asaj kohe të Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së .

Poashtu edhe nga ekspertiza financiare e administruara është vërtetuar se të njëjtat ishin pranuar nga ana e të paditurës dhe se shuma e pranuar e të papaguara arrijnë shumën prej 556,707.38euro.Nga provat e administruara si më sipër,rezulton se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie afariste për furnizim me karburant dhe se e paditura i ka pranuar me shkresën e datës 18.03.2002 si dhe vërtetimin me nr.protokolit 92/07,andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 15 dhe 17 të LMD-së, të cilët parashohin se palët kontraktuese në marrëdhënie detyrimore kontraktuese janë të obliguara ti kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënievereciproke, andaj në bazë të këtyre dispozitave gjykata ka vlerësuar se ekziston obligimi i të paditurës për pagesën e borxhit.

Sipas nenit 262 të LMD-së kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos-përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë

përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumën e gjykuar.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet e përfaqësuesit të së paditurës se, kjo çështje ka të bëjë me çështje të gjykuar një pretendim të tillë gjykata e refuzoj si tëpabauar për faktin se kjo çështje është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit të Kosovës Ac.nr1533/13 dt.20.10.2016, poashtu gjykata vlerësoj edhe pretendimet tjera të të paditurit lidhur me parashkrim edhe ky pretendim është i pa bazuar për shkak se sipas dispozitës së nenit 371 të LMD-së (Gazeta zyrtare RSFJ nr.2978 e datës 26.05.1978), në të cilën thirret e paditura se afati i përgjithshëm i parashkrimit të kërkesëpadiisë është 5 vite, ndërkaq me ndryshimin dhe plotësimin të këtij Ligji të publikuar në Gazetën zyrtare të RSFJ, nr39/85, 45/89 dhe 57/89, si dhe Gazeta zyrtare të RFSJ nr.31/93 është ndryshuar edhe afati i përgjithshëm i parashkrimit të kërkesave prej 5 deri në 10 vjet. Me këtë dispozitë në mënyrë decisive ceket se afati i përgjithshëm i parashkrimit është 10 vjet, nëse me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit, andaj në këtë rast nuk ka parashkrim sepse nga viti 2002 e deri te data e parashkrimit të padiisë 20.03.2008 nuk ka kaluar afati prej 10 vitesh, për më tepër edhe sipas nenit 387 të LMD-së parashkrimi ndërpritet kur debitori e pohon borxhin, në rastin konkret debitori e ka pohuar borxhin me datën 18.03.2002.

Pretelemi tjetër i të paditurit lidhur me atë se nuk ka të lidhur kontratë dhe se nuk është krijuar marrëdhënje afariste me paditësin një pretendim të tillë, gjykata i vlerësoi si ta pabazuar për faktin se i padituri i ka pranuar borxhin me datën 18.03.2002 dhe nuk i ka kundërshtuar në afatin kohor e cila është e përcaktuar sipas ligjit respektivisht sipas dispozitës së nenit 42 paragrafi 3 i LMD, e po ashtu gjykatës nuk i ka ofruar asnjë provë të vetme për ta vërtetuar këtë pretendim, ndërsa sipas nenit 319.1 palët ndërgjyqëse kanë për detyrë që t'i provojë faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj.

Meqenëse e paditura, kanë rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që t'ia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga parashkrimi i padiisë, ndërsa lidhur me vendosjen për afatin paritiv për pagesë në afatin kohor prej 7 ditëve gjykata e ka bazuar në nenin 509 pika (e), të LPK-së, gjykata ka refuzuar pretendimin e paditësit që kamata vjetore të përllogaritet në lartësi prej 8 %, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 1057 të LMD-së, në të cilin thuhet se "*Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji*", andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë: për përpilimin e padiisë në shumë prej 160,00 euro, për ankesë të aktgjykimit C.nr.500/08 dt.26.11.2012 shumën prej 270,00 euro, për pesë seanca nga 325(325x5) në shumë prej 1.625 euro si dhe për ekspertizë shumën prej 300,00 euro gjithësej në vlerë prej 2.355,00 euro.

Duke u bazuar në të lartcekurat dhe duke iu referuar dispozitës së nenit 262 paragrafi 1 ,nenit277, nenit 15 dhe nenit 17 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.C.nr. 420/2017të dt.10.09.2018

G j y q t a r j a
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7(shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.